



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0708

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Center for Legal Services L.L.C kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna e Vushtrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbime juridike për përfaqësim ligjor te Komunës me numër të prokurimit: VU644-25-2905-2-2-1, me 06/10/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE Center for Legal Services L.L.C me nr. 2025/0708 , e datës 30/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbime juridike për përfaqësim ligjor te Komunës me numër të prokurimit: VU644-25-2905-2-2-1.
2. Anulohet B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues, ndërkajshëm aktiviteti i prokurimit Shërbime juridike për përfaqësim ligjor te Komunës me numër të prokurimit VU644-25-2905-2-2-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Center for Legal Services L.L.C

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 08/04/2025, Komuna e Vushtrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Shërbime juridike për përfaqësim ligjor te Komunës me numër të prokurimit VU644-25-2905-2-2-1.

Ndërsa me datën 14/07/2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit ne fjale pasi qe asnjë nga tenderuesit nuk është i përgjegjshëm.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 115,000.00 €

Me 21/07/2025, OE Center for Legal Services L.L.C ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 30/07/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Center for Legal Services L.L.C me nr. 0708/2025 lidhur me aktivitetin Shërbime juridike për përfaqësim ligjor te Komunës me numër të prokurimit: VU644-25-2905-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Center for Legal Services L.L.C janë parashtruar si në vijim:

PRETENDIMI NR. 1 - “Arsyet për eliminimin e OE ‘Center for Legal Services L.L.C.’ janë të pasakta dhe të kundërligjshme.”

Arsyeja për të cilën ne jemi eliminuar nga aktiviteti i prokurimit është si në vijim:

Bazuar në Kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë, sikurse u saktësua më lart, Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TË KËRKESËS DETYRUESE, citat:

“Çmimi i ofertuar duhet të jetë brenda tavanit të çmimeve sipas Rregullores së tarifave të avokatëve dt. 18.03.2017, e cila është në fuqi në momentin e publikimit të këtij njoftimi, dhe të mos jetë nën 50% të vlerës së përcaktuar në Rregulloren e tarifave të avokatëve, konform nenit 4, paragrafi 3 të kësaj Rregulloreje. Operatorët ekonomikë që marrin pjesë në këtë aktivitet të prokurimit janë të obliguar të përmbahen tarifave të Odës së Avokatëve dhe të deklarojnë se nuk do të ofertojnë me çmime nën 50% të tarifave të Odës.”

Në rastin konkret, ju si OE “Center for Legal Services L.L.C.” keni dorëzuar tenderin me çmime të shërbimeve juridike më të ulëta se 50% e çmimeve të parashikuara me Rregulloren mbi Tarifat e çmimeve të Odës së Avokatëve, si vijon:

1. Për kontestin me vlerë (çështje e vogël):

- Për paditësin/të paditurin e dytë është dhënë çmimi prej 58.50 €, ndërsa sipas Rregullores çmimi duhet të ishte minimum 117.00 €;
 - Për paditësin/të paditurin e tretë është dhënë çmimi prej 78.00 €, ndërsa sipas Rregullores çmimi duhet të ishte minimum 156.00 €;
 - Për paditësin/të paditurin e katërt është dhënë çmimi prej 97.50 €, ndërsa sipas Rregullores çmimi duhet të ishte minimum 195.00 €;
 - Për paditësin/të paditurin e pestë është dhënë çmimi prej 117.00 €, ndërsa sipas Rregullores çmimi duhet të ishte minimum 234.00 €.
2. Për kontestin me vlerë mbi vlerën e vogël deri në 10,000 €:
- Për paditësin/të paditurin e dytë është dhënë çmimi prej 78.00 €, ndërsa sipas Rregullores çmimi duhet të ishte minimum 156.00 €;
 - Për paditësin/të paditurin e tretë është dhënë çmimi prej 104.00 €, ndërsa sipas Rregullores çmimi duhet të ishte minimum 208.00 €;
 - Për paditësin/të paditurin e katërt është dhënë çmimi prej 130.00 €, ndërsa sipas Rregullores çmimi duhet të ishte minimum 260.00 €;
 - Për paditësin/të paditurin e pestë është dhënë çmimi prej 156.00 €, ndërsa sipas Rregullores çmimi duhet të ishte minimum 312.00 €.

Për këtë arsye, tenderi i OE-së suaj është cilësuar si i papërgjegjshëm.

Rregullorja e TOA-së është dokument publik, ku secili person mund t'i qaset dhe të konfirmojë lartësinë e shpërblimit të avokatit për një shërbim të caktuar juridik (shih linkun si vijon: <https://www.oak-ks.org/tarifa>). Pra, ky tentim nga AK për të prezantuar çmime të tjera për pozicionet përkatëse, të ndryshme nga ato të përcaktuara me rregulloren e TOA-së, është i pakuptimtë dhe i pabazuar.

Sidoqoftë, për pozicionet për të cilat ne jemi eliminuar, në rregulloren e TOA-së është përcaktuar si më poshtë:

Nr. tarifor 6 - Përpilimi i parashtrësve në procedurën civile dhe procedurat tjera:

Pozicioni	Vlera e çështjes	Baza Paushal	Gjithsej
Kontest i vlerës së vogël	60 €	18 €	78 €
Për paditësin/të paditurin e dytë: +50%	90 €	27 €	117 €
Për paditësin/të paditurin e tretë: +50%	120 €	36 €	156 €
Për paditësin/të paditurin e katërt: +50%	135 €	45 €	195 €
Për paditësin/të paditurin e pestë: +50%	180 €	54 €	234 €

Për kontestin me vlerë mbi vlerën e vogël deri në 10,000 €:

Pozicioni	Baza Paushal		Gjithsej
80 €	24 €	104 €	
Për paditësin/të paditurin e dytë: +50%	120 €	36 €	156 €
Për paditësin/të paditurin e tretë: +50%	160 €	48 €	208 €
Për paditësin/të paditurin e katërt: +50%	200 €	60 €	260 €

Pozicioni	Baza	30% P	Gjithsej
Për paditësin/të paditurin e pestë: +50%	240 €	72 €	312 €

Nga ana tjetër, ne për këto pozicione kemi ofertuar çmimet si më poshtë:

Pozicioni	Baza	30% P	Gjithsej
Kontest i vlerës së vogël	60.00 €	18.00 €	78.00 €
Për paditësin/të paditurin e dytë	45.00 €	13.50 €	58.50 €
Për paditësin/të paditurin e tretë	60.00 €	18.00 €	78.00 €
Për paditësin/të paditurin e katërt	75.00 €	22.50 €	97.50 €
Për paditësin/të paditurin e pestë	90.00 €	27.00 €	117.00 €
Kontest me vlerë mbi 10,000 €	80.00 €	24.00 €	104.00 €
Për paditësin/të paditurin e dytë	60.00 €	18.00 €	78.00 €
Për paditësin/të paditurin e tretë	80.00 €	24.00 €	104.00 €
Për paditësin/të paditurin e katërt	100.00 €	30.00 €	130.00 €
Për paditësin/të paditurin e pestë	120.00 €	36.00 €	156.00 €

Në situacionin “Kontest i vlerës së vogël”:

- Në pozicionin “për paditësin/të paditurin e dytë”, çmimi në TOA është 117 €, ndërsa ne kemi ofertuar 58.5 €. Kjo është saktësisht 50% e vlerës së përcaktuar nga TOA dhe pozicioni është në rregull, sepse çmimi i ofertuar nuk është më i ulët se 50% e çmimit të përcaktuar nga TOA.
- Në pozicionin “për paditësin/të paditurin e tretë”, çmimi në TOA është 156 €, ne kemi ofertuar 78 €. Po ashtu, çmimi i ofertuar është 50% e çmimit të përcaktuar dhe pozicioni është në rregull.
- Në pozicionin “për paditësin/të paditurin e katërt”, çmimi në TOA është 195 €, ne kemi ofertuar 97.5 €. Oferta është në rregull për të njëjtën arsye.
- Në pozicionin “për paditësin/të paditurin e pestë”, çmimi në TOA është 234 €, ne kemi ofertuar 117 €. Oferta është në rregull.

Në situacionin “Kontest mbi kontestin e vlerës së vogël deri në 10,000 €”:

- Për pozicionin “për paditësin/të paditurin e dytë”, çmimi në TOA është 156 €, ne kemi ofertuar 78 € (50% e çmimit të përcaktuar), dhe pozicioni është në rregull.
- Për pozicionin “për paditësin/të paditurin e tretë”, çmimi në TOA është 208 €, ne kemi ofertuar 104 € (50% e çmimit të përcaktuar), dhe pozicioni është në rregull.
- Për pozicionin “për paditësin/të paditurin e katërt”, çmimi në TOA është 260 €, ne kemi ofertuar 130 € (50% e çmimit të përcaktuar), dhe pozicioni është në rregull.
- Për pozicionin “për paditësin/të paditurin e pestë”, çmimi në TOA është 312 €, ne kemi ofertuar 156 € (50% e çmimit të përcaktuar), dhe pozicioni është në rregull.

Pra, aspak nuk qëndron konstatimi i AK-së se ne kemi ofertuar me çmime nën 50% të çmimeve të përcaktuara me TOA. Rrjedhimisht, arsyeja për eliminimin tonë nuk qëndron dhe është në

tërësi e pabazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Është e rëndësishme të përmendet edhe një fjali nga letra standarde për eliminimin tonë, ku thuhet se:

"Pas kapitullit IV, shpërblimi për punën e avokatëve, më konkretisht tek numri tarifar 9 - Mjetet juridike në çështjet civile dhe të tjera, është specifikuar se për përpilimin e mjeteve juridike, avokatit i takon shpërblimi i dyfishuar nga shpërblimi i paraparë për parashtresat me të cilat iniciohet procedura, në përputhje me numrin tarifar 6 (përpadi, kërkesë, prapsim, etj)."

Kjo dispozitë nuk mund të lidhet në asnjë mënyrë me eliminimin tonë nga aktiviteti i prokurimit, pasi formulimi i tillë nuk ka qenë pjesë e dosjes së tenderit. Përmes nenit 59, paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik përcaktohet se:

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Pra, AK nuk mund të eliminojë një ofertë për diçka që nuk ka qenë e specifikuar në mënyrë konkrete në dosjen e tenderit. Përtej kësaj, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet në praktikë, pasi OE do të lidhë kontratën sipas paramasës që ka ofertuar. Nëse ne kemi ofertuar që të përpilojmë një parashtresë me 78 euro, atëherë do të dorëzojmë faturën pranë AK-së me 78 euro (bruto - me TVSH) dhe nuk mund të kërkojmë dyfishimin e shpërblimit vetëm pse ekziston në TOA një dispozitë që nuk ka qenë fare pjesë e dosjes së tenderit.

Nëse një praktikë e tillë është zbatuar më parë në AK, atëherë kjo përbën vepër penale për të cilën duhet të japin përgjegjësi të gjithë personat e përfshirë, pasi kjo nënkupton që në paramasë është dorëzuar një çmim dhe më pas do të faturohet një çmim tjetër nga OE dhe do të paguhet nga AK.

Sidoqoftë, tentimi i AK-së për të lidhur këtë dispozitë me eliminimin tonë është i pashpjegueshëm në aspektin logjik dhe i patolerueshëm në aspektin ligjor (duke qenë se një kërkesë e tillë nuk është cituar specifikisht në dosjen e tenderit dhe paramasë).

Nga sa u tha më sipër, në paramasën që ne kemi ofertuar nuk ekziston asnjë çmim më i ulët se 50% i çmimeve të përcaktuara në TOA. Rrjedhimisht, arsyeja eliminative e përcaktuar nga AK është e pasaktë dhe e padrejtë, pasi ne kemi dorëzuar ofertë të përgjegjshme duke plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit pa asnjë përjashtim.

PRETENDIMI NR. 2 - "AK ka kryer shkelje të rënda të prokurimit në kuptim të nenit 97 paragrafi 1, nënparagrafët f), h) dhe k)"

Sipas nenit 97, paragrafi 1, nënparagrafi k), përcaktohet se "Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit për Prokurimin Publik" përbën shkelje të rëndë disiplinore në procedurën e prokurimit publik. Në rastin konkret, anulimi është kryer në shkelje të plotë të nenit 62 të LPP, pasi oferta jonë është përgjegjëse në tërësi dhe përmbush të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit (DT) pa asnjë përjashtim. Arsyet për eliminim janë tërësisht të pabazuara dhe të kundërligjshme. Më poshtë do të paraqiten argumente konkrete, të matshme dhe të ligjshme që konfirmojnë këtë fakt.

Tutje, në nenin 97, paragrafin 1, nënparagrafin h), përcaktohet se "Mosrespektimi i vendimeve të OSHP-së" është shkelje e rëndë disiplinore në procedurën e prokurimit publik. Në rastin konkret,

OSHP përmes vendimit nr. 2025/0379 ka miratuar në tërësi ankesën tonë, duke pranuar të gjitha pretendimet ankimore. Me këtë vendim, OSHP ka evidentuar se:

- OE “Ekrem Q. Salihu B.I.” është i papërgjegjshëm, pasi ka bërë ndërhyrje në paramasë, ka plotësuar gabimisht formularin e çmimit (devijim aritmetik mbi 2%), si dhe ka vendosur çmime të pakuptueshme që nuk janë në përputhje me formularin e paramasës.

- Për OE “Selimaj Legal Consulting Sh.P.K.”, AK nuk ka paraqitur arsyet eliminuese të evidentuara në letrën standarde, pavarësisht se oferta e këtij operatori ekonomik nuk ka ndryshuar dhe ai nuk ka kundërshtuar këto arsye.

- OE “Juris Concept” ka plotësuar gabimisht formularin e çmimit (devijim aritmetik mbi 2%) dhe referenca e dorëzuar nuk përmbush kërkesat specifike të DT, pasi mungon vlera e kontratës në referencë dhe në listën e kontratave. Për më tepër, nuk mund të kërkohej sqarime shtesë për referencën, pasi kjo do të përbënte ndryshim material të ofertës pas hapjes së ofertave, çka është e ndaluar nga neni 38.2 i RRPP.

Këto arsye eliminuese, të cilat janë paraqitur si pretendime ankimore nga ana jonë dhe të cilat janë miratuar nga Paneli Shqyrtues dhe OSHP, nuk janë evidentuar në letrat standarde për tenderuesit e eliminuar. Kjo është bërë me qëllim nga ana e AK-së, dhe për këtë arsye AK ka shkelur në mënyrë flagrante vendimin OSHP nr. 2025/0379. Kështu, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 97, paragrafin 1, nënparagrafin h) të RRPP.

Vlen të theksohet se të tre operatorët ekonomikë të cekur janë jo vetëm të papërgjegjshëm për mosplotësim të kërkesave të DT-së, por edhe administrativisht të papërgjegjshëm për plotësimin jo korrekt të formularit të DT lidhur me çmimin.

Në përputhje me nenin 97, paragrafin 1, nënparagrafin f), përcaktohet se “Moszbatimi i nenit 30.4 të RRPP nga zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe skadimi i afateve të vlefshmërisë dhe sigurisë së tenderëve” përbën shkelje të rëndë disiplinore. Neni 30.4 i RRPP përcakton se në situata të veçanta kur procesi i vlerësimit nuk mund të përfundohet brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertave, AK duhet të kërkojë zgjatjen e vlefshmërisë nga operatorët ekonomikë, dhe kjo kërkesë duhet të bëhet me shkrim para skadimit.

Në këtë rast, kërkesa për validitetin e ofertës ka qenë vetëm 60 ditë nga data e hapjes së ofertave (30.04.2025), duke nënkuptuar skadimin më 30.06.2025. Megjithatë, ZPP nuk ka kërkuar asnjëherë zgjatjen e vlefshmërisë nga operatorët ekonomikë, duke shkelur kështu nenin 30.4 të RRPP dhe nenin 97, paragrafin 1, nënparagrafin f).

Nga sa më sipër, është argumentuar në mënyrë të qartë dhe të ligjshme se nuk janë plotësuar kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit sipas nenit 62 të LPP, pasi “Center for Legal Services L.L.C.” është i vetmi operator ekonomik që ka përmbushur të gjitha kërkesat e DT-së pa asnjë përjashtim dhe ka përmbushur kriteret për dhënien e kontratës. Prandaj, ky operator duhet shpallur fitues dhe të nënshkruhet kontrata përkatëse.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 01/08/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0708/2025, ndërsa me datë 05/08/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0708/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të

aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Center for Legal Services L.L.C eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0708 ka vlerësuar si në vijim:

Përmledhje mbi ecurinë e procedurës me titull: Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës, dhe numër të prokurimit: VU644-25-2905-2-2-1 udhëhequr nga Komuna e Vushtrrisë.

1.Njoftimi për kontratë është bërë me datë: 08.04.2025

2.Hpja e ofertave është bërë me datë:30.04.2025

3.Njoftimi i Vendimit të autoritetit kontraktues është marrë me datë: 05.05.2025.

5.Operatori ekonomik ankues, Center for Legal Services L.L.C., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, (hera e pare) pranë autoritetit kontraktues – Komuna e Vushtrrisë me datë: 12.05.2025.

6. Pas refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim me date: 16.05.2025 parashtronë Ankesë pranë OSHP-së.

6. Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues për (heren e dytë) është marrë me date: 14.07.2025

7. Me date: 21.07.2025 parashtron kërkesë për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues ku e njëjta i'u është refuzuar .

7. Pas Vendimit për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim, për (heren e dytë) operatori ekonomik Center for Legal Services L.L.C., paraqet Ankesë pranë OSHP-së, me datë: 21.07.2025.

HYRJE:

Operatori ekonomik Center for Legal Services L.L.C. në pretendimet e tij sqaron se në njoftimin e vendimit të autoritetit kontraktues duke shtuar se mga autoriteti kontraktues janë të paqëndrueshme duke i'u referuar tarifave për shërbime juridike ku autoriteti kontraktues ka specifikuar në kërkesën e tij se çmimet e ofruara nuk duhet të jenë më të lira se sa nën 50 % e çmimeve të përcaktuara në rregullren e Odës së Avokatëve përkatësishtë rregulorës (*Në bazë të nenit 21. par. 1 dhe 41 par. 3 pika 3 eLigjit nr. 04/L-193 për avokatinë “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 20 të dt. 31 maj 2013, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, në seancën e datës 18 mars 2017*).

Autoriteti kontraktues në arsyen e eliminimit i ka rënditur disa pozicione të cilat i konsideron se janë nën vlerën e më pak se 50 % të tarifave të rregulluara me rregulloren përkatëse, derisa operatori ekonomik ankues ka ofruar sqarime për secilin pozicione duke i arsyetuar derisa

autoriteti kontraktues i ka konsidereuar se nuk janë në pajtim me kërkesën e autoritetit kontraktues dhe tarifat e rregullorës.

Në vazhdim i paraqesim pretendimet e operatorit ekonomik ankues dhe përgjigjet në pretendime nga eksperti shqyrtues.

PRETENDIMI I PARË

Operatori ekonomik ankues pretendon se është eliminuar nga autoriteti kontraktues pasi që nuk ju ka përmbajtur çmimeve për tarifa të avokatëve dhe kërkesës së autoritetit kontraktues përkatësisht pozicioneve të dy kategorive për pagesa.

Kategoritë :

1. Kontest i vlerës së vogël (pozicionet 1,2,3,4,5) dhe ,
2. Kontest me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000.00 euro për pozicionet (1,2,3,4,5).

Për pozicionet si në vazhdim (dokumenti përshkrimi i çmimit i AK)

Kontest me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000.00 euro

Çmimet për pozicione të operatorit ekonomik të cilat pretendon se janë në pajtim me çmimet e rregullorës për shërbime të avokatëve.

Çmimet e OE për kontest me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000.00 euro.

Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit, Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, ka parashtruar si kërkesës-sqarim sin ë vazhdim:

Cmimi i ofertuar – Tavani çmimet me cmimoren e Rregullores se tarifave te avokateve dt.18.03.2017, e cila eshte ne fuqi ne momentin e publikimit te ketij njoftimi dhe mos te jete nen 50% te vleres te percaktuar ne Rregulloren se tarifave te avokateve konform nenit 4 paragrafi 3 te kesaj rregulloreje.

N vazhdim gjeni krahasimin e çmimeve të ofruara nga operatori ekonomik ankues dhe çmimet për tarifa të avokatëve sipas rregullorës së Odës së Avokatëve.

Kategoria: kontesti i vlerës së vogël.

Pozicioni numër 1

Çmimi i ofertuar nga operatori ekonomik ankues pozicioni numër:1 Çmimi sipas rregullorës për tarifa të avokatëve për pozicionin numër:1 **Për pozicionin numër 1 kontesit i vlerës së vogël:**Operatori ekonomik ka ofertuar në total për pozicon prej: 78.00 euro Rregullorja për tarifa të avokatëve e parasheh vlerën prej: 78.00 euro **Vlera e pozicionet 1 e operatorit ekonomik është e njëjtë me tarifat e rregullorës së odës të avokatëve.**

Pozicioni numër 2

Çmimi i ofertuar nga operatori ekonomik ankues pozicioni numër:2 Çmimi sipas rregullorës për tarifa të avokatëve për pozicionin numër:2 Operatori ekonomik ka ofertuar në total për pozicon prej: 58.50.00 euro Rregullorja për tarifa të avokatëve e parasheh vlerën prej: 117.00 euro ***Çmimi i operatorit ekonomik ankues është fiks 50 % më i lirë se tarifa e odës së avokatëve, nuk ka tejkallim të kërkesës të AK, pasi që AK e ka potencuar se çmimet nuk duhet të jenë nën 50 %***

Pozicioni numër 3

Çmimi i ofertuar nga operatori ekonomik ankues pozicioni numër: 3 Çmimi sipas rregullorës për tarifa të avokatëve për pozicionin numër:3 Operatori ekonomik ka ofertuar në total për pozicon prej: 78.00 euro Rregullorja për tarifa të avokatëve e parasheh vlerën prej: 156.00 euro ***Çmimi i operatorit ekonomik ankues është fiks 50 % më i lirë se tarifa e odës së avokatëve, nuk ka tejkallim të kërkesës të AK, pasi që AK e ka potencuar se çmimet nuk duhet të jenë nën 50 %***

Pozicioni numër 4

Çmimi i ofertuar nga operatori ekonomik ankues pozicioni numër: 4 Çmimi sipas rregullorës për tarifa të avokatëve për pozicionin numër:4 Operatori ekonomik ka ofertuar në total për pozicon prej: 97.50 euro Rregullorja për tarifa të avokatëve e parasheh vlerën prej: 159.00 euro ***Çmimi i operatorit ekonomik ankues është fiks 50 % më i lirë se tarifa e odës së avokatëve, nuk ka tejkallim të kërkesës të AK, pasi që AK e ka potencuar se çmimet nuk duhet të jenë nën 50 %***

Pozicioni numër 5

Çmimi i ofertuar nga operatori ekonomik ankues pozicioni numër: 5 Çmimi sipas rregullorës për tarifa të avokatëve për pozicionin numër: 5 Operatori ekonomik ka ofertuar në total për pozicon prej: 117.00 euro Rregullorja për tarifa të avokatëve e parasheh vlerën prej: 234.00 euro ***Çmimi i operatorit ekonomik ankues është fiks 50 % më i lirë se tarifa e odës së avokatëve, nuk ka tejkallim të kërkesës të AK, pasi që AK e ka potencuar se çmimet nuk duhet të jenë nën 50 %***

Kontest me vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10.000.00 euro

Pozicioni numër 1

Çmimi i ofertuar nga operatori ekonomik ankues pozicioni numër: 1 Çmimi sipas rregullorës për tarifa të avokatëve për pozicionin numër: 1 Operatori ekonomik ka ofertuar në total për pozicon prej: 10400 euro Rregullorja për tarifa të avokatëve e parasheh vlerën prej: 104.00 euro **Vlera e pozicionet 1 e operatorit ekonomik është e njëjtë me tarifat e rregullorës së odës të avokatëve.**

Pozicioni numër 2

Çmimi i ofertuar nga operatori ekonomik ankues pozicioni numër: 2 Çmimi sipas rregullorës për tarifa të avokatëve për pozicionin numër: 2 Operatori ekonomik ka ofertuar në total për pozicon prej: 78.00 euro Rregullorja për tarifa të avokatëve e parasheh vlerën prej: 156.00 euro **Çmimi i operatorit ekonomik ankues është fiks 50 % më i lirë se tarifa e odës së avokatëve, nuk ka tejkallim të kërkesës të AK, pasi që AK e ka potencuar se çmimet nuk duhet të jenë nën 50 %**

Pozicioni numër 3

Çmimi i ofertuar nga operatori ekonomik ankues pozicioni numër: 3 Çmimi sipas rregullorës për tarifa të avokatëve për pozicionin numër: 3 Operatori ekonomik ka ofertuar në total për pozicon prej: 104.00 euro Rregullorja për tarifa të avokatëve e parasheh vlerën prej: 208.00 euro **Çmimi i operatorit ekonomik ankues është fiks 50 % më i lirë se tarifa e odës së avokatëve, nuk ka tejkallim të kërkesës të AK, pasi që AK e ka potencuar se çmimet nuk duhet të jenë nën 50 %**

Pozicioni numër 4

Çmimi i ofertuar nga operatori ekonomik ankues pozicioni numër: 4 Çmimi sipas rregullorës për tarifa të avokatëve për pozicionin numër: 4 Operatori ekonomik ka ofertuar në total për pozicon prej: 130 euro Rregullorja për tarifa të avokatëve e parasheh vlerën prej: 260 euro **Çmimi i operatorit ekonomik ankues është fiks 50 % më i lirë se tarifa e odës së avokatëve, nuk ka tejkallim të kërkesës të AK, pasi që AK e ka potencuar se çmimet nuk duhet të jenë nën 50 %**

Pozicioni numër 5

Çmimi i ofertuar nga operatori ekonomik ankues pozicioni numër: 5 Çmimi sipas rregullorës për tarifa të avokatëve për pozicionin numër: 5 Operatori ekonomik ka ofertuar në total për pozicon prej: 156 euro Rregullorja për tarifa të avokatëve e parasheh vlerën prej: 312 euro ***Çmimi i operatorit ekonomik ankues është fiks 50 % më i lirë se tarifa e odës së avokatëve, nuk ka tejkalim të kërkesës të AK, pasi që AK e ka potencuar se çmimet nuk duhet të jenë nën 50 %***

PRETERNDIMI -2

Operatori ekonomik ankues në pretendimin e tij sqaron se autoriteti kontraktues nuk ka veprua në pajtim me nenin 97 paragrafi 1 nën paragrafi f) h) dhe k) duke ju referuar njoftimit të vendimit të autoritetit kontraktues dhe arsyeve të eliminimit të cilat rrjedhimisht mund të konstatohen me të drejtë në rastin konkret.

Lidhur me pjesën e pretendimit ankimor për operatorin ekonomik Juris Concept për kërkesën për sqarime shtesë në ekspertizën me numër 2025/0379 se nuk është dashur të kërkohej sqarime shtesë është si pjesë e pabazuar e pretendimit ankimor të operatorit ekonomik ankues.

PËRFUNDIM:

Mbi bazën e arsyeve të dhëna vlerësoj se pretendimi i dytë i operatorit ekonomik është pjesërisht i bazuar.

Përfundim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Vushtrrisë, nuk ju ka përmbajtur trajtimin të kërkesave të procedurës të kërkuara me Vendimin parapak të OSHP-së me numër 2025/0379 i datës 10/07/2025.

Mbi bazën e arsyeve të dhëna në këtë raport, dëshmive dhe informacionit të ofruara vlerësoj se:

Ankesa e operatorit ekonomik është e bazuar, Të bëhet anulimi i njoftimit për anulimin e procedurës, dhe; Lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Gjatë ri-vlerësimit autoriteti kontraktues ti trajtoj të gjeturat në ekspertizën e parë dhe të konfirmuara me Vendim të Panelit të OSHP-së nr. 2025/0379 i datës 10/07/2025, dhe gjatë fazes së ri-vlerësimit të ofertave – dëshmive të ofruara nga operatorët ekonomik pjesëmarrës ti trajtoj në pajtim të plotë konform dispozitave ligjore të përcaktuara, konkretisht nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve të LPP-së.

Me raportin e ekspertizës OE është pajtuar, ndërsa AK-ja nuk është pajtuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës”, me numër të prokurimit VU644-25-2905-2-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovet si e bazuar.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues në mbështetje të nenit 1 dhe 7 të LPP-së mbështet raportin e ekspertit shqyrtues dhe ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të Komunës me numër të prokurimit VU644-25-2905-2-2-1, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim. dhe AK të veprojnë në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - Center for Legal Services L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: